

Takim per OGP

Elda Guni
To: Elvisa Sinani; Malvina Sinani; Daniela Skenderi; Florina Hajredinaj; Anxhela Saliassi; Serxhio Koci
Mon 3/30/2026 1:13 PM

66% of recipients have opened this mail.
See more insights Feedback

Përsëritje,

Partneriteti për Qeverisje të Hapur (Open Government Partnership) është një nismë ndërkombëtare që synon nxitjen dhe bashkërendimin e iniciativave konkrete në mbështetje të parimeve të transparencës, gjithëpërfshirjes dhe promovimit të vlerave të qeverisjes së hapur. Në këtë kuadër, Shqipëria është pjesë e Partneritetit për Qeverisje të Hapur (Open Government Partnership) me qëllim nxitjen dhe bashkërendimin e nismave konkrete në mbështetje të parimeve të transparencës, gjithëpërfshirjes dhe promovimit të vlerave të qeverisjes.

Në kuadër të kësaj iniciative, Qendra Kombëtare e Biznesit, ka qenë pjesë e Planit Kombëtar të Veprimit 2023-2025, me 3 (tre) angazhime që lidhen me regjistrimin e të dhënave të pronarëve përfitues dhe përditësimin e tyre nga subjektet raportuese, sipas afateve dhe kërkesave të parashikuara në ligjin "Për Regjistrin e Pronarëve Përfitues", i ndryshuar, konkretisht si mëposhtë vijon:

1. Sensibilizimi dhe ndërgjegjësimi i subjekteve raportuese mbi detyrimin e regjistrimit dhe të përditësimit të të dhënave të pronarëve përfitues;
2. Vlerësimi i praktikave më të mira të vendeve të Bashkimit Europian mbi procesin e regjistrimit të të dhënave të pronarëve përfitues;
3. Rishikimi i legjislacionit në fushën e regjistrimit të të dhënave të pronarëve përfitues, në kuadër të përmirësimit të procedurës së ndjekur mbi regjistrimin e të dhënave të pronarëve përfitues.

Në vijim të këtij procesi, tashmë sic e dini jemi në fazën e hartimit dhe bashkë-krijimit të Planit Kombëtar të Veprimit 2026-2030, i cili zhvillohet në përputhje me parimet themelore të Partneritetit për Qeverisje të Hapur, dialogun e hapur, transparencën, pjesëmarrjen dhe përgjegjshmërinë.

Në kuadër të kësaj iniciative, QKB-ja ka zhvilluar një takim me shoqërinë civile në datë 13.03.2026 dhe gjithashtu në datë 24-25 Mars, QKB-ja ftoi për herë të parë EBRA (European Business Register Association), një rrjet europian që bashkon regjistrat e bizneseve dhe promovon standardet e përbashkëta për transparencën dhe shkëmbimin e të dhënave – një moment që vlerëson progresin tonë në modernizimin e regjistrave të biznesit.

Duke qenë se, eventet e sipërcituara lidhen dhe me angazhimet e ndërmarra në OGP, sugjerojmë të organizojmë një takim ditën e nesërme, ora 10:00, për të diskutuar dhe rishikuar dhe njëherë angazhimet e QKB-së në Planin Kombëtar të Veprimit 2026-2030.

Faleminderit,

Elda Guni

Specialist,
Drejtorja e Kërkimit dhe Udhëheqja Metodologjike
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT
Bulevardi "Zhan D'Ark", Prona nr.33, Shtëpia e Ushtarakeve
Tiranë, Shqipëri
Email: elda.guni@qkb.gov.al
Web: www.qkb.gov.al

Reply Reply all Forward